

Vendim nr. 106 datë 20.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MARJAN QAFA**, përfaqësuar nga avokat Mirgen Gjoci, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4056, datë 19.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 18, 42, 44, 49, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 45, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Marjan Qafa ka nisur marrëdhënien e punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), më 16.11.1999, me detyrë inspektor i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Pukë. Pas kryerjes së detyrave të ndryshme, me urdhrin nr. 2289, datë 27.06.2014 “Për transferimin dhe caktimin në detyrë të një punonjësi policie” të drejtorit të përgjithshëm të policisë kërkuesi është caktuar shef sektori/specialist në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit Korçë (*DKMK*) me gradën “kryekomisar”. Pas transferimit, me urdhrin nr. 609, datë 14.07.2014 të drejtorit të *DKMK*-së kërkuesit i është dhënë e drejta e kryerjes së pushimeve vjetore për periudhën 15.07.2014-31.07.2014. Si pasojë e një aksidenti rrugor kërkuesi është pajisur me tre raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë nr. 0003271, datë 30.07.2014, për periudhën 25.07.2014-08.08.2014, nr. 0728123, datë 30.07.2014, për periudhën 08.08.2014-24.08.2014 dhe nr. 0002217, datë 26.08.2014, për periudhën 26.08.2014-09.09.2014.

2. Me rikthimin në punë pas aksidentit, kërkuesi është njohur me dy urdhra të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, konkretisht me urdhrin nr. 2289/1, datë 01.09.2014 “Lirimi nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie”, me të cilin është liruar nga detyra dhe është vënë në dispozicion të *DPPSH*-së për t’u caktuar në një detyrë tjetër dhe urdhrin nr. 2289/2, datë 01.09.2014 “Lirimi nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie”, me të cilin kërkuesi është liruar nga Policia e Shtetit për mungesë të funksioneve të lira organike, në përputhje me gradën dhe për shkak se nuk ka kërkuar ulje në gradë, duke iu ndërprerë marrëdhënia financiare në datën 01.09.2014.

3. Në datën 12.12.2014 kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë kundër *DPPSH*-së me objekt shfuqizimin e urdhrave të lirimimit nga detyra, rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel, pagesën e pagës nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe, në rast mospranimi të kërimit të parë, ka kërkuar dëmshpërblim me 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës, 3 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës, 1 pagë mujore për çdo vit vjetërsie në punë, si dhe shpenzimet për avokatin.

4. Me vendimin nr.692, datë 16.02.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shpallur moskompetencën territoriale dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 282, datë 02.06.2015, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë, duke shfuqizuar urdhrin nr. 2289/2, datë 01.09.2014 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, detyrimin e palës së paditur, DPPSH-së, të paguajë në favor të kërkuarit një dëmshpërblim me 12 paga mujore, si dhe ka rrëzuar padinë për të gjitha kërkimet e tjera si të pabazuara në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim si kërkuar, i cili ka paraqitur të njëjtat pretendime si në padinë e ngritur në shkallë të parë, ashtu edhe pala e paditur, duke kërkuar ndryshimin e vendimit, si dhe rrëzimin e padisë.

5. Me vendimin nr.3537, datë 18.07.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin nr. 282, datë 02.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke vlerësuar se vendimi është marrë në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr.9749/2007*) dhe të Kodit të Punës, duke mos gjetur shkaqe ligjore për të cenuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit ka ushtruar rekurs kërkuar, i cili ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin tërësisht të padisë.

6. Me vendim nr.00-2023-4056, datë 19.10.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Në datën 21.02.2024 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000 është regjistruar në datën 25.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

- 8.1 *Së drejtës së aksesit*, pasi të tria gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se kërkesa objekt padie, për rikthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës, nuk gëzon mbrojtje ligjore nëpërmjet gjykatave dhe vetëm dëmshpërblimi si pasojë e largimit nga vendi i punës së punonjësit publik, me një akt të pavlefshëm, gëzon mbrojtje gjyqësore, duke mos e arsyetuar këtë qëndrim me argumentet e duhura ligjore dhe pa u shprehur dhe pa u argumentuar në këtë drejtim.
- 8.2 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi deklarimi i gjykatave në vendimet e tyre se rikthimi në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore nëpërmjet gjykatës, është në kundërshtim me nenin 44 të Kushtetutës dhe nenet 146, pikat 1 dhe 3, 147 dhe 155, pika 3, të Kodit të Punës, si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Qëndrimi i gjykatave duke iu referuar në vendimmarrje vendimit unifikues nr.31, datë 14.04.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr.31/2003*) është i paligjshëm, pasi ky vendim ka humbur fuqinë vepruese me miratimin e ndryshimeve të Kodit të Punës, që pranonte konceptin e rikthimit në punë të punonjësit të administratës publike në kushte të caktuara dhe për shkak të evoluimit të qëndrimit të GJEDNJ-së në çështjen Vilho Eskelinen etj. kundër Finlandës. Kodi i Punës rregullon marrëdhëniet në administratën publike, që nuk u nënshtrohen rregullimit me ligj të veçantë dhe kur ligji nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës, përsëri do të gjejnë zbatim dispozitat e këtij kodi. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mbështetur në vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës duhet të zbatonin dispozitat e Kodit të Punës për rikthimin në punë të kërkuarit dhe jo vendimin unifikues nr. 31/2003 të Gjykatës së Lartë.
- 8.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk u ka dhënë përgjigje kërtimeve të ngritura në rekurs për mospërfshirjen në kategorinë e rasteve të përcaktuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Ajo gjykatë ka mbajtur një qëndrim formal, skematik e shumë të thjeshtëzuar, madje nuk ka cituar as përmbledhjen e arsyetimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe thelbin e rekursit që lidhet me zgjidhjen e marrëdhënies së punës në kohë të papërshtatshme. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të ishte investuar në shqyrtimin e

pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, si dhe duhet të ishte shprehur për to, për sa kohë që lidhen me shkeljen e së drejtës për punë e profesion e për rikthimin në punë, si rrjedhojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të paligjshme. Gjykatat e faktit nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kushtetues për të drejtën e punës dhe profesionin, pasi edhe pse e kanë vlerësuar si të pavlefshëm urdhrin për lirim nga detyra dhe kanë dhënë dëmshpërblim për kërkuesin, duke iu referuar Kodit të Punës për rikthimin në punë, kanë mbajtur qëndrimin se largimi nga puna nuk parashikohet në ligjin e posaçëm, duke mos e zbatuar këtë kod, dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, si dhe duke bërë që vendimet e gjykatave të jenë të paligjshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja ”i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin, është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet Gjykatës lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të

procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë e ka përmbushur edhe këtë kriter.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 19.10.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 21.02.2024. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë rezulton se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit të saj dhe është bërë i disponueshëm për palët në datën 06.11.2023, datë nga e cila ka filluar të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

13. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit në gjykatë, të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të sigurisë juridike, Kolegji vlerëson t’i shohë ato në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë që edhe pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike kërkuesi e lidh me mënyrën e arsytimit të vendimeve gjyqësore të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vlerësuar se rikthimi në vendin e mëparshëm të punës nuk gëzon mbrojtje ligjore nëpërmjet gjykatave, duke mos e arsytuar këtë qëndrim të tyre. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, si dhe nuk ka arsytuar për mospranimin e shkaqeve të rekursit. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se në vendimin asaj gjykate nuk është cituar përmbledhja e arsytimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe thelbi i rekursit që lidhet me

zgjdhjen e marrëdhënies së punës në kohë të papërshtatshme. Sipas kërkuarit, gjykatat e faktit, në lidhje me rikthimin në punë nuk kanë zbatuar Kodin e Punës dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, por i janë referuar vendimit unifikues nr.31/2003, i cili është në kundërshtim me nenin 44 të Kushtetutës dhe nenet 146, pikat 1 dhe 3, 147 dhe 155, pika 3, të këtij kodi, si dhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. *(shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr.76, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Për sa i përket standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv *(shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre *(shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje për një padi të kërkuarit, nëpërmjet së cilës është kërkuar, ndër të tjera, shfuqizimi i urdhrave të lirimit nga detyra, rikthimi në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe, në rast mospranimi të kërimit të parë, është kërkuar dëmshpërblim me 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.

18. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, duke shfuqizuar urdhrin nr.2289/2, datë 01.09.2014 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, detyrimin e palës së paditur, DPPSH-së, të paguajë në favor të kërkuesit një dëmshpërblim me 12 paga mujore, si dhe ka rrëzuar padinë për të gjitha kërkimet e tjera si të pabazuara në prova dhe në ligj. Mbi ankimin e të dyja palëve në proces, Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke vlerësuar se është në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr.9749/2007, si dhe të Kodit të Punës, duke mos gjetur shkaqe ligjore për të cenuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

19. Gjykata e Lartë, sikurse edhe dy gjykatat e faktit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, i janë referuar nenit 78 të ligjit nr. 9749/2007, i cili parashikonte largimin/lirimin nga Policia e Shtetit dhe të drejtën për të bërë ankim në gjykatë ndaj një vendimi të tillë, por jo të drejtën e rikthimit në detyrë. Ajo ka vlerësuar se marrëdhënia e punësimit të kërkuesit rregullohej nga ligji nr.9749/2007 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat nuk kishin parashikime për të drejtën për rikthimin në punë të punonjësit të policisë. Ky ligj duhej kuptuar sipas përcaktimeve të vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara nr. 31/2003 dhe nr. 7/2011. Referenca në nenin 3, pika 1, të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes midis palëve, sipas të cilit, punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm ishin nëpunës civilë, ndaj të cilëve ky ligj gjente zbatim, aplikohet për atë që nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm. Ligji i posaçëm i asaj kohe ishte ai nr. 9749/2007, i interpretuar përmes vendimeve unifikuese që nuk parashikonte të drejtën për rikthimin në punë gjyqësisht, pra kjo e drejtë nuk gëzonte mbrojtje gjyqësore (*shih paragrafët 23 dhe 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Gjykatës së Lartë, pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme ligjeve të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim (*shih paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Për sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendimin përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për thelbin e pretendimeve të tij, duke iu garantuar në këtë mënyrë e drejta e aksesit. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i Gjykatës së Lartë paraqet në mënyrë të detajuar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e

zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Kolegji Administrativ, pasi ka vlerësuar shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi, ka vlerësuar se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk gjejnë mbështetje në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

21. Ndërsa për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi vendimi unifikues nr.31/2003 ka humbur fuqinë vepruese me miratimin e ndryshimeve të nenit 155, pika 3, të Kodit të Punës, miratuar me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, që pranon konceptin e rikthimit në punë të punonjësit të administratës publike në kushte të caktuara, por edhe për shkak të evoluimit të qëndrimit të GJEDNJ-së me çështjen Vilho Eskelinen, etj. kundër Finlandës, datë 19 prill 2007, Kolegji vëren se ky pretendim, në thelb, ka të bëjë me identifikimin e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, si edhe me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të tij, çka është një detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj, për rrjedhojë, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se zbatimi i ligjit, ku përfshihet edhe njësimi ose zhvillimi i tij me vendimin unifikues, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në vështrim të sa më lart, Kolegji çmon se, në rastin konkret, interpretimi i ligjit të zbatueshëm gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk rezulton të jetë arbitrar ose i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.